

V E N D I M
Nr.613, datë 6.11.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.129, DATË 6.4.1985 “PËR MBROJTJEN E RRUGËVE DHE QARKULLIMIN RRUGOR”

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 6.4.1985, kapitulli XXIX “Targat e njohjes dhe mbishkrimet e tyre” ndryshohet si vijon:

“XXIX. Dokumentet e qarkullimit dhe targat e mjeteve.

Neni 88

Drejtuesit e mjeteve me motor, kur qarkullojnë me to, duhet të jenë të pajisur dhe të kenë me vete edhe këto dokumente:

- a) certifikatën e sigurimit të detyruar të mjeteve;
- b) dokumentin e taksës së regjistrimit;
- c) lejen e transportit automobilistik për veprimëtarinë ku ato parashikohen në akte të veçanta;
- ç) librezën e automjetit.

Instrukturët, gjatë përgatitjes mësimore me mjetet mësimore, duhet të kenë me vete patentën e caktuar të drejtimit dhe autorizimin përkatës të lëshuar nga organet e policisë rrugore.

Neni 89

Për regjistrimin e automjeteve dhe rimorkiove të tyre që hyjnë për herë të parë në Republikën e Shqipërisë, duhet të verifikohen edhe dokumentet e mjetit si vijon:

- a) tabela identifikuese e vendosur në mjet;
- b) numri identifikues i stampuar në shasi, në mënyrë që të mos ndryshohet.

Për mjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë që nuk plotësojnë kërkesat e pikës “b”, të veprohet në këtë mënyrë:

- Numri i identifikimit të shasisë, kur është i ndryshuar, i falsifikuar, i palexueshëm ose mungon, duhet të ribëhet nga zyrat e drejtorisë së policisë rrugore në Ministrinë e Brendshme.
- Numri i ri i identifikimit të shasisë duhet të stampohet mbi metal me shënues në ofiqinën e parkut të Ministrisë së Brendshme.
- Për mjetet me numër shasie të modifikuar ose të ndryshuar nga ai i shënuar në dokumentet përkatëse, zbatohen dispozitat e ligjit nr.7873, datë 16.11.1994.

Ngarkohet ministri i Brendshëm të nxjerrë rregulla të hollësishme për normat e identifikimit.

Neni 90

Pajisen me targa metalike këto mjetet:

- a) Veturat, mikrobuse, autobusë, kamionët, kamionçinat, traktorët rrugorë, motokarrot, motoçikletat, rimorkiot dhe mjetet e tjera shtytëse, gërmuese e ngritëse me rrota gome.
- b) Motoçikletat me cilindrate mbi 100 cm³ dhe motoçikletat me cilindrate nën 100 cm³, por me shpejtësi të projektuar mbi 30 km/orë.

Neni 91

Rregulla të hollësishme për regjistrimin e mjeteve, si dhe normat për klasifikimin, modelin, prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e targave metalike të mjeteve, nxirren nga ministri i Brendshëm në përputhje me normat e Komunitetit Evropian.

Neni 92

Kur targa metalike humbet ose bëhet e palexueshme, zëvendësohet me targë të re.

Neni 93

Mjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë, që qarkullojnë në territorin e shteteve të tjera, përveç targave metalike, duhet të kenë edhe tabelën me mbishkrimin “AL”.

Neni 94

Vetëm mjetet e shërbimit të policisë së sistemit të Ministrisë së Brendshme pajisen me targa të veçanta me mbishkrimin “Policia”, si dhe u lejohet mbishkrimi “Policia” në faqen e përparme dhe anësore.

Mjetet e shërbimit të policisë rrugore të sistemit të Ministrisë së Brendshme duhet të kenë në faqet anësore mbishkrimin “Policia rrugore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi